

Vizioni ynë

Zoti ynë është një Zot i mirë. Ai transformon zemrën dhe jetën e atyre që besojnë në të duke ndryshuar rrethanat e jetës së tyre. Ungjillizimi dhe kishëmbjellja janë elementë të rëndësishëm të punës sonë në zonën e Mokrës sikurse dhe në të gjithë Shqipërinë.

Kontribuoni dhe ju

Na ndihmoni të zgjerojmë punën sonë dhe ta përhapim atë në fshatra të tjerë:

- **Dhuroni për shërbesën e ungjillizimit në Shqipëri:** për punën e familjes Shkullaku, për shpenzimet e udhëtimeve, qeratë, materialet e punës, fushata ungjillizuese, kampet e fëmijëve dhe të tjera. Transferoni paratë tuaja në llogarinë me emër "Puna Ungjillizuese".
- **Na mbështesni përmes lutjeve:** Lutuni për Shqipërinë, për familjet në zonat rurale, për rritjen e kishave, për misionarët dhe kishat e reja në zonën e Mokrës.
- **Mund të bëheni pjesëmarrës** në shërbesat dhe punën praktike. Datat e planifikuara mund ti gjeni në www.diakonia.al ose duke kontaktuar zyrën tonë.



"Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës."
(Mateu 28:19-20)

DA dhe CHW

Fondacioni Diakonia Albania shërben si një organizatë jofitimprurëse për njerëzit në nevojë. Ajo na çon pas në kohë, pikërisht në punën shumë-vjeçare të Shoqatës së Krishterë për Ndhimë në Wismar (CHW) Gjermani, e cila në 1992 udhëtoi drejt Pogradecit me ndihmat e para.

Diakonia Albania, e themeluar në vitin 2012 organizon shërbimet dhe projektet në zyrat e Pogradecit dhe Tiranës. Njëkohësisht ne bashkëpunojmë me autoritetet shetërore, me organizata të tjera humanitare dhe me shumë vullnetarë nga Shqipëria, Gjermania dhe shumë vende të tjera.



Fondacioni Diakonia Albania

Rruga Mentor Zavalani
7301 Pogradec
T +355 (0) 83-22 87 51
E info@diakonia.al

Zyra Tiranë:
Rruga 4 Dëshmorët
Nr. 56, Tiranë

www.diakonia.al

NIPT: L21423453S
ProCredit Bank Albania, Ilogaria 5513 3004 0001
IBAN: AL20 2094 2553 0000 5513 3004 0001

Anëtar i Vëllazëria Ungjillore E Shqipërisë (VUSH)



Design: Studio2id.de Foto: Saimir Rakiplari, Rigels Lufo dhe të tjera



UNGJILLIZIMI

Duke ndarë Ungjillin, ne sjellim shpresë dhe gëzim tek shqipëtarët

Njerëzit e varfër kanë nevojë për ndihmë praktike, ne jemi duke e bërë këtë nëpërmjet ndihmave dhe projekteve sociale. Por ne kemi më shumë për të dhënë, Mesazhin e Perëndisë që na do të gjithëve dhe që transformon jetët tona.

Jetë e re frymore

Faktorët frymorë që veprojnë në Shqipëri janë të lidhur me 40 vite stalinizëm, tradita islame, kishat e vjetra dhe materializmi modern. Mesazhi i krishterë ofron një alternativë të vërtetë jetëndryshues: Kalimi nga varfëria në një jetë të restauruar dhe me gëzim.

Diakonia Albania mbështet kishën nëpërmjet projekteve në fshatrat e zonës së Mokrës dhe zona të tjera të Shqipërisë. Nëpërmjet ndihmës dhe punës sonë në rritje dhe zhvillim ne ndihmojmë jo vetëm familjet por dhe të gjithë komunitetin në tërësi.



Bishnicë

Pas 15 vitesh punë me kishën të themeluar nga Pastor Frieder Weinhold pati një periudhë 2 vjeçare shkëputjeje. Me kërkesë të besimtarëve dhe të njerëzve të tjerë në fshat, ne rifilluam rregullisht shërbesat të cilat drejtohen nga Samuel Shkullaku. Përveç shërbesës kryesore ne zhvillojmë çdo javë takime fëmijësh dhe grash.

Në Buzaishtë, fondacioni hollandez Agrinas ka zhvilluar projekte agrokulturore që prej vitit 1994, duke ndihmuar familjet fermere dhe duke ndarë ungjillin. Pas ndërprerjes të punës së kishës për disa vite ne rifilluam takimet e kishës ne vitin 2013. Në takimet e përgjithshme të kishës janë pjesëmarrës rreth 40 fëmijë dhe rreth 10 të rinj.

Buzaishtë



Velçan

Laktesh

Samuel Shkullaku dhe të rinjtë e Buzaishtës kanë nisur një grup studimi në fshatin më të populluar, Velçan. Jemi me pritje që ky grup të rritet dhe të zgjerohet në vitet në vijim.

Këta të rinj nga fshati Buzaishtë gjithashtu kanë ndarë ungjillin në fshatin Laktesh. Rreth fundit të vitit 2015 ne filluam shërbesat javore. Në shërbesën e femijëve marrin pjesë rreth 30 fëmijë.

Holtas



Në bashkëpunim me studentët e teologjisë nga Gjermania, ne kemi organizuar fushata verore në fshatin

Holtas për tashmë disa vite. Ne vizitojmë familjet në shtëpitë e tyre dhe zhvillojmë takime fëmijësh, grash dhe burrash.

Në disa fshatra, Samuel Shkullaku jep kurse muzike për besimtarët e rinj duke ju dhënë atyre mundësi të përfshihen në grupet e adhurimit të kishave të tyre.



Puna shpirtërore nga Diakonia Albania është zgjeruar pasi ne punësuar me kohë të plotë Samuel Shkullakun në fund të vitit 2013. Si familje, Samueli dhe Savjola morën një thirrje nga Perëndia dhe i përkushtuan jetët e tyre në ndarjen e Ungjillit në Shqipëri dhe kryesisht në zonat rurale. Ata shkojnë sëbashku në fshatra për të ndarë ungjillin, organizuar shërbesa të ndryshme, takime fëmijësh dhe grash.